



Ministero Istruzione Università Ricerca
Ufficio Scolastico Regionale Lazio
Istituto Comprensivo "D. Cambellotti"
Via della Pineta, 2 – 00040 Rocca Priora (Roma)

Ministria e Arsimit Universiteti i Kerkimeve
Zyra Shkollore Krahina Lazio
Instituti Pergjithshëm (Kopështi, Shkollat Filllore dhe Nëntëvjeçare) "D. Cambellotti"
Rruga Pineta, 2 – 00040 Rocca Priora (Roma)

PRINDERVE TE HUAJ



SI FUNKSIONON SHKOLLA NE ITALI

Informazionet e para për mirëpritjen
e djemëve e vajzave tuaja
Ky broshurë është i përkthyer në dy gjuhë:
shqip dhe romanisht

**MIRESERDHET
NE QYTETIN E ROCCA PRIORA(RM)
E NE SHKOLLAT E TIJ**
të qendrës urbane
e të Fraksionit (ndarjes) Colle di Fuori

Ky libër i vogël na jep rastin që të përshëndetemi përzemërsisht e t'ju ndihmojmë të kuptoni si funksionon shkolla italiane.

Mund të regjistroni menjëherë fëmijët tuaj, edhe nëse viti shkollor ka filluar.

Dijeni se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të frekuentojnë shkollën, edhe se nuk janë në rregull me normat ligjore përsa i përket lejeqëndrimit (permesso di soggiorno).
(ONU; Marrëveshja Internazionale për të Drejtat e Fëmijëve, art.28)





§ SA VJET NE SHKOLLE

Kopështi: nga 3 deri ne 6 vjeç (jo i detyrueshëm)

Shkolla e detyrueshme zgjat 10 vjetë:

- 5 vjet të shkollës Filllore
- 3 vjet të shkollës Nëntëvjeçares
- shkolla Dyvjeçare

Në shkollën filllore shkohet nga mosha 6 deri ne 11 vjeç

Në shkollën tetevjeçare shkohet nga mosha 11 deri në 14 vjeç

Në shkollën e mesme dyvjeçare shkohet nga mosha 14 deri në 16 vjeç

Në shkollën e mesme trevjeçare shkohet nga mosha 16 deri në 19 vjeç

Shkolla e detyrueshme eshte falas

Librat jepen falas vetëm në shkollën filllore; familjet duhen te blejnë fletoret, çantë laps, ngjyra, etj.....

Për të tre nivelet e shkollës prindërit duhet të marrin masat për të paguar kontributin e kërkuar për të siguruar pjesëmarrjen e birit/ës në eskursjonet shkollore e në kampet shkollore në të cilat merr pjesë klasa.

§ REGJISTRIMI NE SHKOLLE

Për të regjistruar vajzen o djalin tuaj në shkollë duhet të presantoheni në zyrat e sekretarisë, ne pikën qendrore në **Rrugën Pineta** për të plotësuar kërkesën e regjistrimit.

Dokumentat që duhen prezantuar:

- Çertifikata e lindjes së fëmijës
- Çertifikata e vaksinave
- Deklerata e lëshuar nga shkolla ku fëmija vazhdonte studimet para se të vinte në Itali.

Në qoftë se në momentin e regjistrimit nuk kanë këto dokumenta, mjafton të bëjnë një deklaratë të studimeve të kryera deri në atë moment.

Drejtori i shkollës ose një mësuese e ngarkuar për këtë qëllim do të kujdeset për hyrjen në klasë të djalit apo vajzës tuaj.

Në momentin e regjistrimit bëhet zgjedhja për:

- Lloj shkolle(kohë e gjatë o kohë e shkurtër)
- Vendndodhja e shkollës (Rocca Priora o Colle di Fuori)
- Mësimi apo jo i Besimit Fetar
- Regjistrime në mensën e shkollës
- Regjistrimi në transportin me autobus shkollor

§ CILIN LLOJ ORARI

Në Kopësht prindërit mund të zgjedhin mes këtyre:

1) Kohë të kufizuar: nga 8,20 dei ne 13,20 nga e hëna deri të premten

2) Kohë të plotë: nga 8,20 dei ne 16,20 nga e hëna deri të premten

me drekë ne shkollë

Nëse shkolla juaj ndodhet në Colle di Fuori hyrja dhe dalja janë 10 minuta më parë.

Në shkollën Fillore prindërit mund të zgjedhin mes dy mundësish:

1) 27 orë javore nga 8,10 dei ne 13,40 nga e hëna deri të premten

2) 40 orë javore nga 8,10 dei ne 16,10 nga e hëna deri të premten

me drekë në shkollë

Në shkollën Nëntëvjeçare prindërit mund të zgjedhin mes dy mundësish:

1) me kohë të normale: nga 8,00 dei ne 14,00 nga e hëna deri te premten

2) me kohë të zgjatur: të hënën dhe të premten nga 8,00 deri në 14,00

të martën, të merkurën dhe të enjtën nga 8,00 deri në 16,00

§ SI TE KERKONI SHERBIMIN E MENSES

Për të patur këtë shërbim, të administruar nga Komuna, prindërit duhet të pajisen me një cartë të personalizuar për secilin fëmijë që do të shërbejë për pagesën e ushqimit të konsumuar çdo ditë. Carta mund të kërkohet pranë Zyrave të Comunes duke i telefonuar këtij numri: 06/940751301. Informazione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të Komunës sito www.comune.roccapriora.roma.it

Për arsye shëndeti o feje, është e mundur të kërkoni një dietë të posaçme në momentin e regjistrimit pranë sekretarisë së shkollës.

§ NESE BANONI LARG NGA SHKOLLA

Eshtë e mundur të kërkoni transportin shkollor ne autobusin e shkollës duke paguar ratën vjetore. Ky shërbim ofrohet nga komuna. Per të patur informazion mbi funksionimin e tij mund të përdorni të njëjtin numër telefoni ose të lidheni me sitin e Komunes

§ KALENDARI SHKOLLOR

Viti shkollor zgjat rreth 9 muaj.

Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në gjysëm të qershorit.

Kopështi mbaron me 30 Qershor.

Janë dy periudha pushimesh :

Dy jave në Krishtlindje(zakonisht nga 23 dhjetori deri me 6 janar) ;

Një javë pothuaj për Pashkë(në mars o në prill).

Janë pastaj disa ditë pushimesh të shpërndara gjatë vitit.

Shkolla njofton çdo herë me një lajmërim të shkruar në ditar të vajzës o djalit tuaj.

E'shtë e rëndësishme të kontrolloni gjithmonë ditarin.

§ MUNGESAT NE SHKOLLE

Prindëri duhet të justifikojë arësyen, çdo herë që fëmija nuk shkon në shkollë.

Për shkollën Fillore dhe Nëntëvjeçare justifikimi duhet të jetë i shkruar në bllokun që tërhiqet fillimisht nga njëri prej prindërve pranë qendrës shkollore që frekuenton vajza apo djali.

Në rast sëmundje mbi 5 ditë, duhet raporta e doktorit në të cilën deklaron që fëmija është shëndoshur në mënyrë që të kthehet sërish në shkollë.

Meqë pjesëmarrja në shkollë është shumë e rëndësishme, janë të pranueshme 50 ditë mungesa në mënyrë që viti shkollor të jetë i vlefshë

§ C'FARE MESOJNE FEMIJET NE SHKOLLE

Instituti i Pergjithshëm(që përfshin disa shkolla) ka një(POF)Plan të Ofertës Formative, që gjendet në faqen e internetit shkollor të konsultueshme në adresën :

www.icroccapriora.it

Në kopësht nëpërmjet një metode ludico- shprehëse, fëmijët mësojnë të lidhin shoqëri e të respektojnë rregullat e bashkëjetesës. Ndër të tjera zhvillojnë aftësi e marrin njohjet paraprake për studimin e lëndëve me të cilat do të përbadhen në shkollën fillore.

Në shkollën fillore e nëntëvjeçare nxënësit mësojnë këto lëndë;

Gjuha italiane

Gjuha e huaj (nga klasa e parë e shkollës fillore: anglisht; në shkollën nëntëvjeçare mund të shtojnë frëngjishten)

Matematikë

Shkencë e teknologji(edukim shkencor e informative)

Histori

Shtetësi e kushtetuta

Gjeografi

Vizatim(art e imazh)

Gjymnastikë(shkenza e lëvizjes e edukim fizik))

Muzikë

Mesim feje

Shkollat e këtij Instituti ofrojnë gjithashtu një sërë projektesh jashtë-shkollore falas e facultative, që vendosen vit pas viti.

Për nxënësit që kanë vështirësi për të studjuar ose me aftësi të kufizuara është i parashikuar një shërbim ndihmës për studim gjatë orarit shkollor, i zhvilluar nga mësues të trajnuar përkatësisht.

Për të kërkuar këtë shërbim, prindërit duhet ti drejtohen Qendrës neuropsikiatrike për fëmijë të ASL RMH1 te Frascati, që ndodhet në rrugën Enrico Fermi 2, tel. 06/94044204

§ SI VLERESOHEN REZULTATET SHKOLLORE

Çdo vit shkollor është i ndarë në dy pjesë, 2 simestri.

Në janar e në qershor mësuesit bëjnë një vlerësim të rezultateve të nxënësit/es e pregatisin dëftesën që do ju dorëzohet familjes në fund të vitit shkollor. La performanca e nxënësit/es është e shprehur me një vlerësim numerik në dhjetëshe, vlerësimi për sjedhjen shprehet me një mendim o me një notë.

Gjatë vitit gjithashtu mësuesit regjistrojnë notat e nxënësit në një bllok shkollor për të informuar prindërit në mënyrë të herë pas herëshme mbi ecurinë në mësim.

§ MBLEDHJET MES PRINDERVE DHE MESUESVE

Gjatë vitit shkollor organizohen disa mbledhje klase mes mësuesve dhe përfaqësuesve të prindërve, të zgjedhur më parë në prezencën e të gjithëve.

Këto janë raste shumë të rëndësishme për të njohur më mirë programin e studimit, për të biseduar së bashku për situatën shkollore në përgjithësi e për të vendosur një bashkëpunim mes shkollës dhe familjes, të dobishem për edukimin e djemëve dhe vajzave.

§ TAKIME INDIVIDUALE

Mësuesit u komunikojnë prindërve ditën e takimit për të biseduar për nxënësin/en, për vështirësitë dhe progreset e tyre, në një takim individual. Prindërit gjithashtu mund të kërkojnë mësuesve një takim nëse duan të dinë se si angazhohet në shkollë fëmija i tyre apo se kanë nevojë për sqarime o këshilla nga ana e mësuesve.

§ HYRJA NE SHKOLLE

Për të hyrë në klasën e re, për tu orientuar në shkollë dhe për të qenë i ndihmuar në momentet e para të njohjes, djali o vajza juaj do të jetë i shoqëruar nga mësuesit e mund të ketë pranë fëmijë të tjerë të të njëjtës shtetësi, që janë në të njëjtën klasë, të regjistruar më parë e tashmë të integruar.

Në bazë të burimeve e mundësive të shkollës, mund të ketë ndihmën e një mediatori (ndërmjetësues kulture)që(gati gjithmonë) flet gjuhën tuaj amtare.

Mediatori mund të takojë edhe familjen.

Familja e huaj gjithashtu mund të kërkojë një takim me mediatorin (përkthyes, ndërmjetësues).

Per të favorizuar përvetësimin e gjuhës italiane, mësuesit do të organizojnë aktivitete të mësimi të italishtes së folur e të shkruar në disa momente didaktike të caktuara e do të favorizojnë përvetësimin e disiplinave duke thjeshtuar tekstet.

KUJTOHUNI

Nëse keni ndonjë paqartësi o vështirësi mund t'ju drejtoheni gjithmonë mësuesve.

Në Institutin tonë është e pranishme një mësuese me funksion strumental për interkulturën dhe një Komision i mësuesve që ndihmojnë hyrjen e nxënësve të huaj në klasa, edhe duke përgatitur material didaktik te dobishëm për këtë qëllim.

Mund ti drejtoheni gjithashtu edhe (Shoqatës Tuskolana për Solidaritet) A.T.S, që u jep emigrantëve të huaj të gjithë ndihmën dhe mbështetjen e mundëshme.

Numra dhe adresa:

Tel.0694017429

fax n. 06 940 17 023

qendra në :rrugen Frascati, 94 Monteporzio Catone 00040 (RM)

Numra dhe adresa të nevojshme

Pika qendrore, rruga Pineta 2

Centralino

Zyrat e sekretarisë

tel. 06/94074012

tel. 06/9472135

fax 06/9472273

Qendra e Shkollës Fillore, rruga Saarlois tel. 06/9470943

Fax. 06/9472011

Zona Colle di Fuori, Piazza Capranica tel. 06/9461472

fax 06/9461132

Drejtori i shkollave

F.S e Komisioni Nderkulturor(i interkulturës)

Lingua albanese -

TRADUZIONE CONFORME ALL'ORIGINALE A CURA DEL SERVIZIO DI MEDIAZIONE - A.T.S. - PER L'ISTITUTO COMPRENSIVO DUILIO CABELLOTTI. A.S.2011-12